

SONILA BOÇI

**POLITIKA E SHTETIT KOMUNIST SHQIPTAR
NDAJ MINORITETEVE NË SHQIPËRI
(1944-1948)**

Përfaqja e shteteve ndaj çështjes së minoriteteve ndryshoi pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Ende pa mbaruar lufta në bisedimet për përgatitjen e projektit të Kartës së OKB, të zhvilluara në Dumbarton Oaks (gusht-tetor 1944), mbizotëroi pikëpamja se sistemi i mbrojtjes së minoriteteve i krijuar nga Lidhja e Kombeve kishte shumë pika të dobëta dhe duhet të ndryshohej në mënyrë radikale¹. Në marrëveshjet, apo konferencat e mëvonshme mes tre Aleatëve të Mëdhenj të Luftës, çështja e mbrojtjes së minoriteteve nuk u mor në shqyrtim. Në Konferencën e Potsdamit (korrik-gusht 1945), u fol vetëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe për vendosjen e një demokracie të zhvilluar në botën e pasluftës². Mirëpo, ndarja e botës në dy blloqe kundërshtarë si pasojë e Luftës së Ftohtë, rezultoi dhe në përfaqje të reja ndaj çështjes së minoriteteve. Doktrina politike e liberalizmit civil u vu përballë doktrinës marksiste të internacionalizmit proletar.

Shtetet perëndimore të demokracive liberale e bënë të vetën doktrinën politike të liberalizmit civil³. Ndërsa Perëndimi fliste për të

¹ Vladimir Ortakovski, *Minority in the Balkan*, New York: "Transnational Publisher", Inc: Ardsley 2004, f. 140.

² Për më tepër shih: *Foreign Relations of the United States: diplomatic papers* (më tej: FRUS) viti 1945, vol. II, edited by United States Department of State, Washington: United States Government Printing Office, 1967.

³ Sipas doktrinës së liberalizmit civil, shteti është një bashkësi individësh (qytetarësh), të cilët përbëjnë edhe kombin. Shtetet që mbështeten në këtë doktrinë konsiderojnë se të gjithë qytetarët, pavarësisht kombësisë së tyre të origjinës, i përkasin shtetit – komb. E vetmja marrëdhënie e vlefshme në një shoqëri të organizuar në këtë mënyrë është midis shtetit dhe qytetarëve individualë. Në këto shoqëri nuk ka vend për minoritetet si një kolektivitet që mund të kërcënojë unitetin e kombit. Për më tepër mbi këtë doktrinë shiko: Will Kymlicka, *Multicultural citizenship: a liberal theory of minorities rights*, Oxford University Press, 1995, f. 37-44. Ky parim u përfshi dhe në Kartën e OKB, të miratuar në tetor 1945. Sipas saj, shtetet anëtare të Kombeve të

drejtat e njeriut, shtetet në anën tjetër të Perdes së Hekurt kishin zgjedhur një qasje tjetër ndaj çështjes së minoriteteve: doktrinën marksiste të internacionalizmit proletar⁴. Por në Ballkanin e nacionalizmave, të dyja përfaqesjet e reja ndaj mbrojtjes së minoriteteve hasën në një terren të vështirë për t'u zbatuar. Kjo, pasi shtetet dhe minoritetet në Ballkan nuk ishin të gatshme të hiqnin dorë nga nacionalizmi i tyre, as në emër të të drejtave liberale, as në emër të luftës së klasave.

Bashkuara duhet të njihnin, respektonin dhe realizonin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut “pa dallim race, seksi, gjuhe apo besimi”. Për më tepër në lidhje me këtë shiko: *Karta e OKB, Kapitulli I, neni 1, pika 3*; si dhe *Ethnic Minorities in the Balkan Studies, 1860-1971, Volume 6, 1918-1971*, editor Bejtullah Destani, London: Archive Edition, 2003, f. 503-508, relacion nga delegati i Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me mbrojtjen e minoriteteve.

⁴ Kjo teori bazohej në marrëdhëniet ekonomike të shoqërisë njerëzore. Shtetet, të cilat mbështeteshin në këtë doktrinë, nuk i referoheshin ndasive kombëtare dhe etnike. Nacionalizmi konsiderohej atribut i borgjezisë dhe i luftës së saj imperialiste. Në konceptin marksist, proletariati nuk ka atdhe, pasi ai në çdo shtet shtypet njësoj nga borgjezia. Në parim, internacionalizmi proletar është i papajtueshëm me “mbrojtjen dhe ngritjen e interesave kombëtare të një vendi të veçantë” por është “plotësisht i pajtueshëm me mbështetjen e lëvizjeve kombëtare antiimperialiste, veçanërisht nëse ato janë socialiste në orientim”. Për më tepër shiko: Horac B. Davis, *Towards a Marxist Theory of Nationalism*, New York and London: Monthly Review Press, 1985, f. 17. Lenini gjatë Revolucionit të Tetorit të vitit 1917 në Rusi theksonte se: “Në krahasim me të gjitha format e nacionalizmit, marksizmi përparon duke u shtrirë përtej kufijve kombëtarë dhe, amalgamën e tërë kombeve synon ta kthejë në një njësi të pathyeshme. Shiko: Mark Mazower, *Ballkani, një histori e shkurtër*, Tiranë: “Skanderbeg Books”, 2003, f. 137. Mbështetur në idetë e Leninit për nacionalizmin dhe çështjet nacionale, Stalini botoi në periudhën midis dy luftërave një broshurë me titull “Marksizmi dhe çështja kombëtare”. Ky botim, siç pohon me të drejtë studiuesi grek Evangelos Kofos, u shndërrua në biblën komuniste për problemet kombëtare dhe minoritetet dhe u zbatua më vonë në të gjitha shtetet komuniste në Evropën Qendrore dhe Lindore. Stalini e konsideronte si “detyrë të lartë të partive komuniste” t’i bënin ballë nacionalizmit dhe të ruanin popujt nga epidemia e përgjithshme e tij (Josif V. Stalin, *Veprat*, vëll. 2, Tiranë: 1954, f. 290). Sipas tij, nacionalizmi tentonte të krijonte një front të përbashkët mes punëtorëve dhe borgjezisë “kundër elementëve kombëtarë të huaj [minoriteteve kombëtare] në shtetin në të cilin jetonin ose kundër kombit fqinj”. Kjo, sipas Leninit dhe më pas Stalinit, ishte “pengesa kryesore” për “krijimin e shoqërisë socialiste”. Prandaj përballë nacionalizmit duhej të vihej “arma e sprovuar e internacionalizmit: uniteti i përbotshëm i luftës së klasave”. Në lidhje me minoritetet, internacionalizmi do të thoshte që klasa punëtore duhej të ngrihej kundër borgjezisë kombëtare të vendit të saj që shtypte minoritetet, por, në të njëjtën kohë, duhej të luftonte dhe borgjezinë e minoriteteve, e cila kërkonte bashkimin me shtetin amë.

Politika e shtetit shqiptar ndaj minoriteteve për “bashkim-vëllazërim”

Për shkak të peshës së vogël specifike të minoriteteve në shoqërinë shqiptare, ato nuk përbënin ndonjë problem shqetësues për qeverinë e Shqipërisë. Mendoj se kjo ishte arsyeja pse qeveria komuniste nuk hartoi ndonjë platformë politike specifike në lidhje me minoritetet.

Politika e shtetit shqiptar ndaj minoriteteve u bazua në parimet e internacionalizmit proletar dhe u ravijëzua në varësi të situatave specifike që paraqiteshin. Për rrjedhojë, politika e shtetit shqiptar ndaj minoriteteve pati ndryshimet e veta në vartësi të shumë faktorëve: marrëdhëniet e shtetit shqiptar me shtetet amë të minoriteteve; qëndrimi politik dhe sjellja e minoriteteve ndaj shtetit shqiptar por dhe ndaj shtetit amë; nevoja e shtetit shqiptar për të vendosur nën kontrollin e tij të gjitha aspektet e jetës politike, ekonomike dhe sociale në vend, pra dhe në zonën ku jetonin minoritetet.

Edhe në periudhën 1944-1948, ashtu si në periudhën midis dy luftërave, në qendër të politikave dhe shqetësimeve të shtetit shqiptar ishte minoriteti grek. Kjo, jo vetëm sepse ishte minoriteti më i madh në vend, por dhe për veçantitë që shfaqte. Ndërsa, minoriteti sllavo-maqedonas karakterizohej nga një qëndrim i butë dhe luajal ndaj shtetit shqiptar, një tjetër panoramë shfaqej në minoritetin grek. Situata në minoritetin grek nuk ishte aspak e qetë, pasi në të nuk mungonin bërthamat e irredentizmit, të nxitura këto dhe nga qeveria greke dhe qarqet vorio-epirote. Greqia, shteti amë i minoritetit grek, jo vetëm dallohej nga shteti shqiptar për sistemin politik që kishte zgjedhur, por kishte ngritur dhe pretendime territoriale ndaj tij. Këto qëndrime ishin premisë negative jo vetëm në ndërtimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve por edhe të raporteve të shtetit shqiptar me minoritetin grek. Në të kundërtën, minoriteti maqedonas dhe serbo-malazez, përveç peshës jo të rëndësishme numerike, kishte prapa tij një shtet amë, i cili po jetonte fazën e një miqësie të ngushtë me shtetin shqiptar. Qoftë në planin e brendshëm politik, qoftë për sa i takonte sovranitetit dhe territorialitetit, minoriteti jugosllav nuk konsiderohej, gjatë viteve 1944-1948, se rrezikonte shtetin dhe qeverinë shqiptare. Ndërkohë, për minoritetet kulturore-linguistike si vllahët, romët etj., nuk pati ndonjë politikë të veçantë dhe u punua për integrimin e tyre.

Në mënyrë të përmbledhur drejtimet kryesore të politikës së shtetit shqiptar ndaj minoriteteve mund t'i analizojmë të ndara në tre grupe:

Në radhë të parë shteti shqiptar synoi krijimin e kushteve të nevojshme për integrimin e minoriteteve në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të vendit, duke i pranuar ata si shtetas me të drejta të barabarta.

Në radhë të dytë, shteti shqiptar u angazhua në sigurimin e disa elementëve, që siguronin ruajtjen e identitetit kombëtar të minoriteteve. Me gjithë të metat dhe mangësitë që mund të vërehen në këtë proces shteti shqiptar krijoi mundësi për shkollimin në gjuhën amtare dhe ruajtjen e kulturës tradicionale të minoriteteve.

Një vend të veçantë në politikën e shtetit shqiptar në raport me minoritetet ishte ndërmarrja e politikave që eliminonin ndasitë etnike në vend. Ky ishte parakusht dhe për kohezionin politik dhe social në Shqipërinë komuniste.

T'i analizojmë në mënyrë më të zgjeruar të tre drejtimet e politikës shqiptare ndaj minoriteteve.

Integrimi. Integrimi i minoriteteve ka qenë një politikë shumë e pranuar nga shtetet në të cilat zbatohet parimi i liberalizmit shtetëror. Ka mjaft debate në qarqe të ndryshme studiuesish në lidhje me çështjen e integritit të grupeve etnike dhe kombëtare në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike të shtetit ku jetojnë. Debati lidhet me faktin se integrimi si proces, ashtu si dhe globalizmi, mbart rrezikun e humbjes së një pjese të identitetit kombëtar për të pranuar disa tipare të identitetit të shtetit ku jeton. Në Ballkan ku ngarkesat nacionaliste janë të fuqishme, rreziku që integrimi të çojë në humbjen e identitetit është edhe më i madh. Pavarësisht këtij rreziku, integrimi është një proces i domosdoshëm dhe pozitiv, nëse rregullat e bashkekzistencës dhe të kulturës qytetare respektohen nga të gjithë⁵. Nëse bëhet në këto kushte, integrimi në mënyrë të natyrshme siguron mbijetesën ekonomike dhe politike të grupeve etnike dhe kombëtare. Në të kundërtën, nëse nuk do të lejohej integrimi i minoriteteve atëherë ato do të detyroheshin të konservoheshin duke humbur ritmet e zhvillimit.

Shteti shqiptar i pas Luftës së Dytë Botërore, që në momentet e para të krijimit të vet, i hapi rrugë integritit të minoriteteve greke dhe jugosllave në territorin e shtetit shqiptar. Në Deklaratën për të Drejtat e Qytetarit, qeveria provizore shqiptare garantonte barazinë e të gjithë

⁵ *Paqe e papërfunduar*, Raporti i Komisionit Ndërkombëtar për Ballkanin, Tiranë: "Shtëpia e Librit", 1996, f. 170.

shtetasve para ligjit⁶. Një vendim i tillë nënkuptonte se një nga synimet e saj ishte krijimi i kushteve për integrimin e minoriteteve në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit. Kjo vijë politike e shtetit shqiptar u përforcua pas miratimit të Statutit të RPSH më 14 mars 1946, i cili sanksiononte dhe njëherë vullnetin e shtetit shqiptar për t'u siguruar mundësi të barabarta të gjithë shtetasve. Për më tepër Statuti, i cili ishte një model i kushtetutës sovjetike të vitit 1936, reflektonte doktrinën internacionaliste të Leninit për çështjen e minoriteteve dhe kombësive. Në nenin 12 të Statutit, në mënyrë të përgjithshme, pranohej se “nuk njihej asnjë privilegj për shkak origjine, pozite, pasurie ose shkallë kulturore⁷”. Ky nen i bënte jehonë një shoqërie pa klasa dhe privilegje. Neni 13 garantonte të drejta të barabarta për të gjithë shtetasit “pa ndryshim kombësie, race ose feje...⁸”. Ndërsa neni 14 i tij, u garantonte minoriteteve, ashtu si të gjithë shtetasve me kombësi shqiptare, të drejtën për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre, ashtu dhe për t'u zgjedhur në organe të larta shtetërore⁹. Në këtë mënyrë, në dokumentin më të rëndësishëm ligjor të shtetit shqiptar ishin sanksionuar vullneti i shtetit shqiptar për integrimin e minoriteteve në jetën e vendit.

Minoritarët grekë dhe maqedonas që kishin mbështetur Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe që vazhdonin të mbështesnin reformat që po ndërmerre qeveria shqiptare u bënë menjëherë pjesë e strukturave më të larta partiake dhe shtetërore. Kështu, Spiro Pano, i lindur në fshatin minoritar të Vanistës, u emërua në prill të vitit 1945, Sekretar i Komitetit qarkor të PKSh në Elbasan dhe më pas në Shkodër. Manol Konomi, i lindur në fshatin Theologo, të banuar nga popullsi greke, u caktua ministër i Drejtësisë që në Mbledhjen e Dytë të Beratit, Kristo Themelko, nga fshati maqedonishtfolës i Bilishtit, Vërniku, ishte anëtar i KQ të PKSH dhe zv/ministër i brendshëm.

Shumë qytetarë shqiptarë me kombësi greke dhe maqedonase ishin përfshirë në strukturat lokale të qeverisjes. Në bazë të ligjit për zgjedhjet e këshillave nacionalçlirimtarë të lokaliteteve, të nënprefekturave dhe

⁶ *Dokumente të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacional-çlirimtar*, botim i Institutit të Historisë së Partisë pranë KQ të PPSH, Tiranë: 1962, f. 295, Deklaratë e Mbledhjes së Dytë të KANÇ-it për të drejtat e qytetarëve, 23 tetor 1944.

⁷ Asambleja Kushtetuese, *Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë*, Tiranë: “Bashkimi”, 1946, f. 6.

⁸ *Po aty*.

⁹ *Po aty*.

prefekturave, të aprovuar në 23 tetor 1944 “anëtarët e këshillave nacionalçlirimtare të katundeve të qyteteve të nënprefekturave zgjidhen në mbledhjet e përgjithshme të katundit, të qytetit dhe të lagjes së qytetit”¹⁰. Ky ligj jo vetëm u jepte mundësi minoritarëve për të zgjedhur njerëzit që dëshironin t’i drejtonin, por dhe të zgjidhnin në këshilla njerëz të zonës, pra minoritarë. Gjithashtu, i njëjti ligj parashikonte që për çdo 250-300 banorë të zgjidhej një përfaqësues në Këshillin Nacionalçlirimtar të Prefekturës¹¹. Kjo u jepte mundësi minoritarëve grekë dhe maqedonas të zgjidhnin përfaqësuesit e tyre në Këshillat e nënprefekturave, prefekturave etj.

Sipas ndarjes administrative të vitit 1945¹², minoriteti grek kishte mundësi të përfaqësohej bindshëm në Këshillin Nacionalçlirimtar të nënprefekturës së Delvinës me të paktën 21 anëtarë nga 62 gjithsej¹³; Këshillin Nacionalçlirimtar të nënprefekturës së Gjirokastrës me të paktën 36 përfaqësues nga 115 anëtarë të Këshillit. Gjithashtu, në bazë të këtij ligji minoriteti maqedonas përfaqësohej në Këshillin Antifashist të nënprefekturës së Korçës me 7-8 anëtarë.

Dokumentet dëshmojnë se minoritarët kanë mbajtur poste të rëndësishme edhe në pushtetin lokal. Veçanërisht shumë i përfaqësuar ishte në të gjithë qarkun e Gjirokastrës, minoriteti grek. Kështu, kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit nacionalçlirimtar të nënprefekturës së Libohovës ishte minoritar grek¹⁴. Gjithashtu, sipas të dhënave të qeverisë shqiptare në komitetin ekzekutiv të këshillit nacionalçlirimtar të nënprefekturës së Qendrës, Gjirokastrë ishin punësuar tre minoritarë, në Delvinë dy, në Sarandë një, në Konispol dy¹⁵.

Që minoriteteve u ishin ofruar mundësi të barabarta integrimi dhe punësimi me shqiptarët e vënë në dukje dhe zyrtarët më të lartë shqiptarë

¹⁰ *Dokumente të organeve të larta të pushtetit ...*, f. 186, Ligjë mbi zgjedhjet e këshillave nacionalçlirimtarë të lokaliteteve, nënprefekturave dhe prefekturave, aprovuar në mbledhjen e dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, 23 tetor 1944.

¹¹ *Po aty*.

¹² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi 490, viti 1945, dos. 333, fl. 24-25.

¹³ Analiza është mbështetur në llogaritjet e lokaliteteve me popullsi të pastër minoritare, ndërkohë që nuk dimë si janë ndarë përfaqësuesit për Këshillin Nacionalçlirimtar në lokalitete me popullsi të përzier.

¹⁴ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti 1945, dos. 20, fl. 94.

¹⁵ *Po aty*, fl. 64-65.

të kohës në të gjitha daljet e tyre publike. Sipas deklaratave zyrtare të kohës që me krijimin e zonave të lira, pra para largimit të ushtrive pushtuese nga territori shqiptar, “në lokalitetet minoritare u formuan KNÇ me krejt persona minoritarë, si dhe këshilla nacionalçlirimtarë të krahinave dhe komandat e vendit”¹⁶. Këtë deklaroi dhe Enver Hoxha në seancën plenare të Konferencës së Paqes në Paris, kur tha se minoriteti grek “e ushtron vetë pushtetin lokal si populli shqiptar”¹⁷. Integrimi i minoritetit grek në strukturat qeverisëse pranohet dhe nga misionet perëndimore që gjendeshin në Shqipëri pas luftës. Kështu, në raportin e kreut të misionit ushtarak britanik, Hoxhson (Hodgson) mbi rezultatet e vëzhgimit të tij në zonën ku jetonte minoriteti grek thuhet: “Në Delvinë ku shumica e popullit është e minoritetit grek, kjo e fundit ka një shumicë të madhe në pushtetin lokal. Minoriteti grek në Shqipëri si del qartë këtu është i lirë të marrë pjesë në jetën politike dhe qeveritare”¹⁸.

Veçanërisht i përfaqësuar ishte minoriteti grek në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare. Në vitin 1945, sipas statistikave zyrtare, në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare kishte “më shumë se 40 oficerë minoritarë dhe dyfishin nënoficerë. Oficerët kanë luajtur një rol me shumë rëndësi gjatë LNÇI dhe sot kanë përgjegjësi të ndryshme si: inspektorë të shkollave minoritare, inspektorë ushtarakë, komisarë dhe komandantë n/batalioni e regjimenti, komandantë në Divisionin e Mbrojtjes Popullore apo në Drejtorinë Politike”¹⁹.

Në të gjitha organizatat e masave: BRASH, BGASH etj., drejtuesit komunistë kishin kujdes të veçantë të përfshinin dhe përfaqësues nga minoritetet. Në Këshillin e Përgjithshëm të BGASH ishte anëtarë Kaliopi Ziko, nëna e Thanas Zikos, një prej dëshmorëve minoritarë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare²⁰.

Në listën e kandidatëve të Frontit për zgjedhjet e Asamblesë Kushtetuese kishte katër anëtarë të minoritetit grek: Spiro Xhai, Lefter Konomi, Manol Konomi dhe Mihal Prifti, nga të cilët tre të fundit u votuan për në Asamblenë Kushtetuese dhe pas kthimit të saj në Kuvend Popullor në mars 1946, ata ishin deputetë të tij.

¹⁶ *Po aty*, fl. 94.

¹⁷ Enver Hoxha, *Dy popuj miq*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1985, f. 38.

¹⁸ *AMPJ*, viti 1945, dos. 11, fl. 137.

¹⁹ *Po aty*, viti 1945, dos. 20, fl. 94.

²⁰ *Po aty*.

Nga statistikat zyrtare të viteve 1945-1948, minoritarët grekë i gjen me shumicë nga strukturat shtetërore, ushtarake dhe partiake. Në vitin 1946 në rrethin e Gjirokastrës, përgjegjësi i seksionit të punëve të brendshme dhe shefi i seksionit të Sigurimit të Shtetit, poste këto nga më të besuarat dhe më të rëndësishme për regjimin, ishin minoritarë. Poste të rëndësishme mbanin anëtarë të minoritetit grek dhe në strukturat më të larta të PKSH në rrethin e Gjirokastrës²¹. Inkuadrimi i kuadrove me kombësi greke ishte një direktivë e qartë e KQ të PKSH. Kështu, në 26 shkurt 1946 Koçi Xoxe, sekretari organizativ i KQ të PKSH, udhëzonte komitetin qarkor të PKSH për rrethin e Gjirokastrës: “duhet të plotësoni vendet në Komitetet e Konispolit dhe Delvinës me elementë të shëndoshë minoritarë vendas, të ngrihen të rinj, por të jenë të kjartë”²².

Siç mund të kuptohet qartë nga parashtrësja e mësipërme, për drejtuesit komunistë nuk kishte problem përfshirja dhe integrimi i minoritetit në të gjithë strukturat administrative dhe politike. Shqetësimi i tyre i vetëm ishte që njerëzit e integruar nga minoritetet të ishin mbështetës të Frontit; të ndiqnin me përpikëri vendimet e marra nga qeveria provizore shqiptare si dhe të zotëronin gjuhën shqipe.

Pjesë e integritit ishte dhe mësimi i gjuhës shqipe. Pikërisht për shkak të mos përdorimit të gjuhës shqipe nga një pjesë e mirë e minoritarëve²³, gjatë viteve 1944-1948, qeveria shqiptare hasi vështirësi në integrimin e tyre. Në qendër të shqetësimit të qeverisë shqiptare edhe në këtë proces ishte minoriteti grek, pasi minoriteti maqedonas dhe ai malazez, për shkak të marrëdhënieve ekonomike me pjesën tjetër të popullsisë shqiptare në periudhat midis dy luftërave, i flisnin lirshëm të dy gjuhët. Ndërkohë, minoriteti grek i kishte mbajtur më shumë lidhjet me Greqinë, ndërsa me Shqipërinë vetëm një pakicë e tyre. Për këtë arsye, mësimi i gjuhës shqipe për minoritetin grek ishte një parakusht i domosdoshëm për integrimin e tyre.

²¹ AQSH, Fondi 14/Arkivi i PPSH (më tej: AP) strukturë, viti 1946, dos. 84, fl. 39-54, mbi kuadrin në rrethin e Gjirokastrës.

²² *Po aty*, viti 1946, dos. 84/8, fl. 5, Letër e Koçi Xoxes, sekretar organizativ i KQ të PKSH për komitetin qarkor të PKSH, Gjirokastër, nr. prot. 273, datë 26 shkurt 1946.

²³ Nga dokumentet e kohës kuptojmë se një pjesë e madhe e minoritetit grek nuk flisnin fare shqip, veçanërisht gratë. Ndërsa për minoritetin maqedonas dhe malazez raportet tregojnë se burrat në përgjithësi janë bilingualë, ndërsa gratë flasin vetëm gjuhën e nënës.

Por, për qeverinë shqiptare kishte dhe një arsye më shumë mësimi i gjuhës shqipe. Në procesin e edukimit komunist të shtetasve shqiptarë, qeverisë komuniste i duheshin kadro, të cilët të bëheshin përçues të kësaj ideologjie tek pjesa tjetër e popullsisë. Ky ishte një shqetësim i vazhdueshëm i drejtuesve komunistë lokalë. Në 12 maj 1945, komiteti qarkor i PKSH i rrethit të Gjirokastrës në një raport për KQ të PKSH njoftonte se kishte shumë vështirësi për ngritjen e kadrove në minoritet, pasi ata nuk lexonin në shqip dhe megjithëse ishin “kulturalisht të ngritur ata nuk ngrihen [kupto: nuk ndërgjegjësohen politikisht] shpejt për të mësuar lëndën tonë [mësimet politike], sepse dhe ata që mund ta lexojnë nuk mund ta kuptojnë”²⁴.

Kuptohet mospërdorimi i gjuhës së shtetit ku jetojnë është pengesë për integrimin e të gjitha grupeve etnike dhe kombëtare, nga kjo pikëpamje kërkesa e shtetit shqiptar për përdorimin e shqipes nga kadrot e minoriteteve ishte një kërkesë e ligjshme e qeverisë shqiptare. Nga ana tjetër, nuk mund të mohohet se me anë të integritit të minoriteteve, qeveria shqiptare kërkonte të krijonte një avangardë mbështetësisht të komunizmit në zonat minoritare. Duke i lënë minoritarët mbështetës të komunizmit të drejtonin pjesën tjetër të popullsisë minoritare, qeveria shqiptare do ta kishte më të lehtë pranimin nga ana e minoritarëve të regjimit komunist.

Me shtimin e kontrollit të shtetit në të gjitha nivelet e jetës politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit, kërkesat për mësimin e gjuhës shqipe nga minoriteti grek, veçanërisht të asaj pjese që mund të zinte poste drejtuese po vinte duke u rritur. Në janar të vitit 1947, sekretari i Komitetit qarkor të PKSH për Gjirokastrën, Mihal Bisha njofton se “po haset vështirësi në edukimin e kadrit në minoritet, sepse nuk flitet dhe lexohet gjuha shqipe”²⁵. Në mungesë të literaturës në gjuhën greke mësimi i gjuhës shqipe u bë dhe më crucial. Komiteti qarkor i PKSH për qarkun e Gjirokastrës njoftoi se për të siguruar mundësinë e edukimit komunist të minoritetit “jemi duke organizuar kurse për gjuhën shqipe”²⁶. Gjatë vitit 1947, në kushtet e një mungese komunikimi me shtetin amë,

²⁴ *AQSH*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 8, fl. 12, Raport organizativ i komitetit qarkor të PKSH për Gjirokastrën, mbi përgatitjen e kadrove komunistë në minoritetin grek

²⁵ *Po aty*, viti 1947, dos. 57, fl. 83, Raport i muajit dhjetor i komitetit qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSH, 6 janar 1947.

²⁶ *Po aty*.

ishin vetë minoritarët grekë që kërkonin të mësonin gjuhën shqipe. Kështu, në zonën e Delvinës minoritarët grekë “kërkojnë me këmbëngulje t’u çelen shkolla ose kurse për të mësuar gjuhën shqipe”²⁷.

Fakt shumë domethënës për përpjekjet e shtetit shqiptar për integrimin e minoriteteve në jetën ekonomike shqiptare është zbatimi i Reformës Agrare. Zbatimi i saj kishte rëndësi si për minoritetet, ashtu dhe për qeverinë shqiptare. Për minoritetet në Shqipëri, të cilat kryesisht nuk zotëronin tokë, i vinte në të njëjtin rang me shumicë shqiptare. Për qeverinë shqiptare zbatimi i Reformës Agrare kishte rëndësi sa politike dhe ekonomike²⁸. Duke qenë se pjesa dërrmuese e minoriteteve jetonin në zonë rurale, qeveria shqiptare do të shtonte mbështetësit e saj, veçanërisht nga popullsia e varfër dhe e pa tokë e tyre. Zbatimi i Reformës Agrare ishte, gjithashtu, një grusht i rëndë për fushatën diplomatike dhe mediatike të qeverisë greke, sipas së cilës qeveria shqiptare po kërkonte asimilimin dhe ndryshimin e strukturës etnike të popullsisë.

Zbatimi i kësaj reforme mori një rëndësi të veçantë dhe për një arsye tjetër. Një pjesë e minoritarëve grekë, sidomos ata që jetonin në krahinën e Pogonit, kishin pasur toka në pjesën greke të kufirit. Gjatë vitit 1945, ata me një vendim të veçantë të KANÇ-it kishin arritur të merrnin leje për t’i punuar tokat e tyre²⁹. Por, nga fillimi i vitit 1946 me mbylljen e kufijve për shkak të acarimit të marrëdhënieve shqiptarogreke, për këta banorë u bë e pamundur të përdornin pronat e tyre në pjesën greke të kufirit. Me të drejtë komiteti qarkor i PKSh për Gjirokastrën njoftonte qendrën e tij se ky ishte “një problem që lyp zgjidhje të shpejtë”³⁰, pasi ato toka ishin mënyra e vetme e jetesës së tyre. Lidhja e fshatarëve minoritarë me tokat e tyre i kishte detyruar ata, sipas komitetit qarkor të PKSh për Gjirokastrën, që të arratiseshin. Për të

²⁷ *Po aty*, viti 1947, dos. 251, fl. 1-2, relacion i Instruktorit të KQ mbi gjendjen në Delvinë.

²⁸ Ligji për Reformën Agrare u shpall në 29 gusht 1945. Ai filloi të zbatohet që në vitin 1945 në disa rajone të vendit, por në krahinat ku banonte minoriteti grek dokumentohet të ketë filluar vetëm pas shkurtit 1946. Për më tepër mbi Reformën Agrare dhe rëndësinë e saj për qeverinë komuniste shiko: Nikolas Pano, *The People’s Republic of Albania*, Baltimore: “The Johns Hopkins Press”, 1968, f. 60-61.

²⁹ *AQSH*, Fondi 489, viti 1945, dos. 138, fl. 1, Letër e Kryesisë së KANÇI për Këshillin Nacionalçlirimtar të Gjirokastrës, nr. 012, 23 prill 1945.

³⁰ *Po aty*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1946, dos. 6, fl. 45, Konkluzion i Plenumit të komitetit qarkor të Gjirokastrës, 9 mars 1946.

zgjidhur këtë çështje, komiteti qarkor i PKSh i kishte propozuar KQ të PKSh dhe qeverisë që “sa më shpejt të ndahen ndër këta bujq tokat e grekëve që kanë këtej kufirit dhe disa toka të një manastiri”³¹. Por një propozim i tillë nuk ishte pranuar nga qeveria me pretendimin se tokat do të ndaheshin nga Reforma Agrare³².

Pavarësisht, qëllimeve të qeverisë shqiptare në zbatimin e Reformës Agrare, si dhe të metave që mund të kishte në zbatimin e saj, ideja që t’u merrej toka pronarëve shqiptarë, për t’ua shpërndarë atë minoritarëve ishte një qëndrim mjaft pozitiv i qeverisë shqiptare³³. Rrallë mund të gjendet një sjellje e tillë e një shteti ndaj minoriteteve që ai ka nën juridiksion. Ky veprim u publikua nga shtypi shqiptar, madje dhe nga ai jugosllav, i cili njoftoi përfundimin e Reformës Agrare në zonat e minoritetit grek në Shqipëri³⁴. Drejtuesit lokalë, gjithsesi ishin të kënaqur nga rezultatet e zbatimit të Reformës Agrare, pasi, sipas tyre, ishte arritur të bëhej për vete “një pjesë e mirë e popullit të minoritetit”³⁵.

Identiteti. Politika integruese e një shteti mund të çojë në humbjen e karakterit kombëtar të një minoriteti nëse nuk shoqërohet me masa për ruajtjen e identitetit kombëtar të tyre. Enver Hoxha, në cilësinë e kryetarit të qeverisë provizore kishte deklaruar se “Qeveria Demokratike e Shqipërisë do t’i garantojë minoritetit grek në vendin tonë liritë dhe të drejtat demokratike dhe nacionale”³⁶. Një deklaratë e tillë shprehte se,

³¹ *Po aty*.

³² *Po aty*, fl. 45, shënim me shkrim dore, firma e palexueshme.

³³ Zbatimi i Reformës Agrare nuk eci me ritmet që priste qeveria shqiptare. Kjo shkaktohej, sipas drejtuesve lokalë, jo aq nga neglizhenca se sa “për difikultetet që ka pasur zbatimi i Reformës Agrare në qarkun tonë në lidhje me gjendjen e tokave”. Në qarkun e Gjirokastrës, p.sh. kishte shumë bujq të pa tokë, ndërkohë që nuk kishte çifligje të mëdha. Sasia e tokave zotërohej nga shumë pronarë, të cilëve, nëse u lihej parcela që u takonte sipas ligjit, nuk mbetej tokë për bujqit. Komiteti qarkor i PKSh për Gjirokastrën në kundërshtim me ligjin për Reformën Agrare kishte vendosur shpronësimin total të tokave dhe racionimin e tyre për të gjithë bujqit e qarkut. Si pasojë e vështirësive që ndeshi zbatimi i Reformës Agrare në qarkun e Gjirokastrës, deri në 17 gusht 1946, pra, një muaj para afatit që ishte vendosur për ta përfunduar plotësisht atë, ishin ndarë 90 328 ha tokë, në 14 460 familje me 103 440 frymë gjithsej. Nga kjo shumë e përgjithshme kishin përfituar 23 fshatra minoritare greke, 729 familje bujqish, të cilëve u ishin dhënë 4042 ha.

³⁴ *AMPJ*, viti 1946, dos. 96, fl. 65, Raport për shtypin i atasheut shqiptar në Beograd për periudhën 8-14 shtator.

³⁵ *AQSh*, Fondi 14/AP strukturat, viti 1946, dos. 57, fl. 3.

³⁶ Enver Hoxha, *Dy popuj miq ...*, f. 22.

synim tjetër i politikës shqiptare ndaj minoriteteve ishte “ruajtja e identitetit kombëtar të tyre”³⁷. Në optikën pragmatiste të Enver Hoxhës ishte e qartë që nëse shteti shqiptar do të mohonte të drejtat gjuhësore dhe kulturore të minoriteteve do të shkaktonte pakënaqësi tek popullsia dhe do të rriste numrin e opozitarëve të regjimit të tij. Në të kundërtën, garantimi i ruajtjes së identitetit të tyre kombëtar, i afronte ata me regjimin dhe i bënte më luajalë.

Ruajtja e identitetit kombëtar të minoriteteve nuk mbeti vetëm në kuadrin e deklaratave publike, por ajo u sanksionua në një sërë aktesh ligjore të shtetit shqiptar. Në Deklaratën për të Drejtat e Qytetarit³⁸ shprehej qartë se qeveria shqiptare garantonte “lirinë e fesë dhe të ndërgjegjes, si dhe të drejta të barabarta për të gjitha fetë”³⁹. Kjo garantonte ruajtjen e besimit si një pjesë e rëndësishme e ruajtjes së identitetit kulturor të minoritetit grek dhe atij maqedonas e malazez. Ruajtja e identitetit kombëtar për të gjitha minoritetet që jetonin në Shqipëri u sanksionua dhe në Statutin e RPSH. Sipas këtij Statuti “pakicat nacionale kanë në Republikën Popullore të Shqipërisë të gjitha të drejtat, mbrojtjen e zhvillimin kulturor të tyre dhe përdorjen e lirë të gjuhës së tyre”⁴⁰. Siç mund të kuptojmë nga ky nen, garantimi i ruajtjes

³⁷ Kjo do të thoshte se, si linjë politike, qeveria shqiptare mori masa dhe u angazhua për sigurimin e kushteve për arsimimin e minoritarëve në gjuhët amtare përkatëse, si dhe përpjekje për ruajtjen e kulturës dhe fesë së tyre.

³⁸ Deklarata për të Drejtat e Qytetarit u shpall në 23 tetor 1944, pas Mbledhjes së Dytë të KANÇ-it. Deklarata mbështetet tek parimi i liberalizmit shtetëror dhe nuk përmend në mënyrë specifike minoritetet. Por, duke qenë se deklarata garantonte barazi për të gjithë nënshtetasit, mund të arrijmë në përfundimin se atyre u garantoheshin të drejta dhe liri si qytetarë të shtetit. Në të nuk përmendet asgjë specifike për minoritetet, por disa nga parimet e saj i garantojnë të drejta indirekt edhe atyre. Në Deklaratën mbi të Drejtat e Qytetarëve, shpallej parimi për barazinë e shtetasve përpara ligjit. Ajo, gjithashtu shpallte lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë, si dhe barazinë e të gjitha feve. Shpallja e këtyre parimeve si dhe e parimeve të garantimit të lirisë së fjalës, mbledhjes, shtypit, e drejta e pronës etj., ishin më shumë karakteristike e shoqërive liberale, sesa atyre komuniste. Pra, kjo është një shembull konkret për fazën transitore që po kalonte Qeveria Demokratike për vendosjen e një regjimi të mirëfilltë komunist.

Në të vërtetë, Qeveria Demokratike nuk mendonte t’i përmbahej parimeve të shpallura në këtë Deklaratë. Jo më kot ajo zgjodhi këtë instrument juridik, pra deklaratën për shpallur të drejtat e qytetarit. Sipas parimeve të jurisprudencës, deklaratat nuk kanë fuqinë e ligjit, pasi ato vetëm shpallin të drejtat, por nuk i garantojnë ato.

³⁹ *Dokumenta të organeve të larta të pushtetit ...*, f. 296.

⁴⁰ Asambleja Kushtetuese, *Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë ...*, neni 35, f. 12.

së identitetit ishte vetëm për minoritetet kombëtare, dhe jo ato linguistike, gjë që përjashtonte vllahët nga sistemi shtetëror i mbrojtjes së identitetit të minoriteteve. Parimet e sanksionuara nga Statuti i RPSH, në lidhje me të drejtat arsimore të minoriteteve i përforcoi Ligji i Reformës Arsimore i 17 gushtit të vitit 1946, sipas të cilit do të krijoheshin kushte për zgjerimin e arsimit në të gjithë vendin dhe rritja e mundësive reale për gjithsecilin për të ndjekur falas shkollën pa dallim seksi, gjendje shoqërore apo kombësie⁴¹.

Shtyllat e identitetit të një kombësie janë gjuha, kultura, zakonet dhe besimi⁴². Arsimimi i minoritarëve në gjuhën amtare, si dhe përdorimi i saj si në ambiente publike ashtu dhe private janë shtyllat më të forta të ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit kombëtar. Një nga masat e para që mori qeveria shqiptare ishte hapja e shkollave në zonat minoritare si greke, ashtu dhe maqedonase. Gjithashtu, qeveria shqiptare lejonte përdorimin e gjuhës së minoriteteve si në ambiente publike, ashtu dhe në administratën shtetërore lokale. Të paktën këtë e kemi të dokumentuar mjaft qartë për minoritetin grek. Një shkresë e këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar për Këshillin nacionalçlirimtar të Gjirokastrës thuhej se të gjitha dokumentet zyrtare që u drejtohen katundeve grekophone “të redaktohen në të dyja gjuhët: shqip e greqisht. Për ta bërë si duhet këtë punë mund të krijohen zyra përkthimesh në prefektura mikse”⁴³.

Arsimimi i minoritetit grek në gjuhën amtare. Në vjeshtë të vitit 1943, në mbledhjen e arsimtarëve të minoritetit grek të mbajtur në Poliçan, Lëvizja Nacionalçlirimtare kishte njohur të drejtën e minoritetit grek të arsimohej në gjuhën e tij amtare⁴⁴. Për vitin shkollor 1944-1945 u hapën 79 shkolla në gjuhën greke në shumë fshatra me popullsi minoritare⁴⁵. Nga statistikat e Ministrisë së Arsimit në minoritet ishin hapur më shumë fshatra nga sa kishte pasur minoriteti në periudhën midis dy luftërave. Kështu, në vitin shkollor 1936-1937 në minoritetin grek

⁴¹ Eriketa Kambo, *Arsimi në Shqipëri (1945-1960)*, Tiranë: “Mësonjëtorja”, 2005, f. 35.

⁴² Për më tepër shiko: Anthony D. Smith, *National Identity (ethnonationalism in comparative perspective)*, London; New York: “Penguin Books”, 1991, f. 23-28.

⁴³ *AQSH*, Fondi 489, viti 1945, dos. 138, fl. 1, Letër e Kryesisë së KANÇI për Këshillin Nacionalçlirimtar të Gjirokastrës, nr. 012, 23 prill 1945.

⁴⁴ *Po aty*, Fondi 14/AP, viti 1944, dos. 94, fl. 1, Raport i Koço Tashkos drejtuar Enver Hoxhës, mbi punën në Qarkun e Gjirokastrës.

⁴⁵ *AMPJ*, viti 1946, dos. 6, fl. 60, Statistika të shkollave minoritare.

kishte pasur 74 shkolla⁴⁶. Sipas statistikave zyrtare edhe për vitin 1945-1946 në gjithë qarkun e Gjirokastrës (Gjirokastrë, Delvinë, Sarandë) ishin hapur shkolla në gjuhën greke në 70 fshatra minoritare⁴⁷, nga 84 të njohura nga qeveria shqiptare në atë kohë. Në këto shkolla ishin të regjistruar 5171 nxënës dhe vazhdonin shkollën në mënyrë të rregullt 4670 prej tyre⁴⁸. Në shkollat minoritare greke jepnin mësim 101 mësues⁴⁹.

Nëse do ta krahasojmë numrin e shkollave në fshatrat e minoritetit grek me ato të hapura në fshatrat shqiptare, mund të themi se fshatrat e minoritetit grek, kishin më shumë shkolla se popullsia shqiptare, qoftë e qarkut të Gjirokastrës, qoftë në shkallë Republike⁵⁰. Sipas statistikave të kohës në vitin shkollor 1944-1945 në të gjithë Shqipërinë kishte 928 shkolla me 54360 nxënës dhe 1743 mësues. Raporti midis shkollave të hapura në fshatrat minoritare ishte 1 shkollë për 443 banorë, ndërsa në zonën shqiptare ky raport shkonte 1 shkollë në 1077 banorë. Kështu, në rrethin e Kurveleshit, shumë afër gjeografikisht me zonën ku banonte në shumicë minoriteti grek, gjatë vitit shkollor 1944-1945 vetëm gjysma e fshatrave kishte shkolla, ndërkohë që në minoritetin grek kishte 30-40% më shumë⁵¹.

Pas miratimit të Reformës Arsimore më 17 gusht 1946, si dhe të ligjit për detyrimin shkollor, filloi fushata për masivizimin e shkollës⁵². Në këtë proces masivizimi u përfshi dhe minoriteti grek. Në vitin shkollor 1947-1948, raportojë se në minoritetin grek ishte realizuar detyrimi shkollor në masën 95%⁵³, por në zona të veçanta, si p.sh në zonën minoritare të Delvinës ky detyrim ishte zbatuar 100%⁵⁴.

⁴⁶ *Po aty*.

⁴⁷ *Po aty*, viti 1946, dos. 128/5, fl. 45-46, Statistika të shkollave minoritare të qarkut të Gjirokastrës.

⁴⁸ *Po aty*.

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ Për më tepër mbi statistikën shih: Eriketa Kambo, *Zhvillimi i revolucionit kulturor në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948*, Tiranë: 1982, f. 117-127.

⁵¹ "Arsimi në minoritet", në *Bashkimi*, 22 gusht 1945.

⁵² Për më tepër mbi këtë proces shih: Eriketa Kambo, *Arsimi në Shqipëri ...*, f. 39-42.

⁵³ *AQSH*, Fondi 14/AP Organet Udhëheqëse (më tej: OU), viti 1947, dos. 6, fl. 15-17, Proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH, mbi gjendjen politike-ekonomike në rrethin e Korçës, Kukësit, Gjirokastrës, 14 shkurt 1947.

⁵⁴ *Po aty*, viti 1947, dos. 251, fl. 1-2, Relacion i Instrukturit të KQ mbi gjendjen në Delvinë, pa datë

Pavarësisht vullnetit të shprehur të qeverisë shqiptare për të garantuar me ligj dhe faktikisht të drejtat arsimore të minoritetit grek, ky proces nuk kaloi pa probleme. Në vitin 1944, autoritetet qeverisëse lokale të qarkut të Gjirokastrës kishin zbatuar parimin e vetëdeklarimit të kombësisë duke i premtuar popullit të zonës se mund të hapnin çfarë shkollë të donin⁵⁵, pra dhe të mësonin atë gjuhë që e ndjenin më afër. Kjo politikë solli si pasojë që gjatë vitit 1944-1945 të hapeshin shkolla në gjuhën greke dhe në fshatra me popullsi shqiptare, apo me popullsi të përzierë, duke vazhduar pa vetëdije procesin e helenizimit të Shqipërisë së Jugut, të filluar nga qarqet greke që në vitet e paraluftës.

Komiteti qarkor i PKSH të qarkut Gjirokastrë bëri autokritikë për këtë punë të gabuar të bërë pas çlirimit me popullsinë shqiptare të zonës së Gjirokastrës. Për të parandaluar këtë fenomen, në një letër të kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar dërguar Këshillit Nacionalçlirimtar të qarkut të Gjirokastrës më 23 prill 1945 thuhej: “katundet shqipfolëse do të kenë shkolla shqipe, qofshin këto katunde dhe në mes të katundeve grekofone”⁵⁶. Kjo politikë solli mbylljen e disa shkollave greke në fshatra të konsideruara shqiptare. Një situatë aspak të këndshme për qeverinë shqiptare solli mbyllja e shkollave greke në dy fshatrat e konsideruara shqiptare Frashtar dhe Lugar⁵⁷. Popullsia e të dyja fshatrave i bëri rezistencë hapjes së shkollave shqipe dhe gjatë vitit shkollor 1945-1946 nuk u çel në këto fshatra as shkollë shqipe, as greke⁵⁸. Në shtator të vitit 1946, me urdhër të Ministrisë së Arsimit u hap një shkollë shqipe, por ky urdhër përsëri hasi në rezistencën e popullsisë, madje dhe të

⁵⁵ *Po aty*, viti 1946, dos. 57, fl. 76, Raport i muajit nëntor i komitetit qarkor të PKSH të prefekturës Gjirokastrë për KQ të PKSH, 14 dhjetor 1946.

⁵⁶ *Po aty*, Fondi 489, viti 1945, dos. 138, fl. 1, Letër e Kryesisë së KANÇI për Këshillin Nacionalçlirimtar të Gjirokastrës, nr. 012, 23 prill 1945.

⁵⁷ Frashtari dhe Lugari janë dy fshatra me popullsi ortodokse në qendër të zonës minoritare. Popullsia e këtyre dy fshatrave ishte bilingue, ata flisnin dhe shqip dhe greqisht. Deri në vitin 1942 atje kishte pasur shkollë shqipe dhe drejtuesit lokalë këmbëngulnin për kombësinë shqiptare të banorëve të këtyre fshatrave. Për shkak të pozicionit të tyre gjeografik dhe afërsisë me fshatra minoritare, banorët e Frashtarit dhe Lugarit kishin bërë krushqi me fshatrat minoritare. Për këtë arsye mendoj se aty duhet të jetë krijuar një përzierje popullsie, e cila mesa duket me kalimin e kohës ka anuar nga ajo greke. Problemi i hapjes së shkollave greke në këto dy fshatra është përsëritur dhe pas shembjes së diktaturës komuniste gjatë viteve 1992-1994. Aktualisht sot popullsia e këtyre dy fshatra është konsideruar minoritare dhe kanë shkollë në gjuhën greke.

⁵⁸ *AQSH*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1946, dos. 57, fl. 76, Raport i muajit nëntor i komitetit qarkor të PKSH të prefekturës Gjirokastrë për KQ të PKSH, 14 dhjetor 1946.

komunistëve të Frashtarit dhe Lugarit. Komiteti qarkor i PKSh për Gjirokastrën u dha urdhër komunistëve për të dërguar fëmijët e tyre në shkollën shqipe. Një pjesë e tyre pranoi, sipas raportit të Komitetit qarkor të PKSH, “jo se ishin sqaruar mirë, por se u dha urdhër nga partia”⁵⁹. Pavarësisht nga rezistenca dhe kundërshtimet e popullsisë, komiteti qarkor i PKSh për Gjirokastrën mori vendim për t’i hapur shkollat shqipe në këto fshatra në një kohë sa më të shkurtër dhe për të dërguar në këto shkolla anëtarë partie që të ishin të lidhur me komitetin qarkor⁶⁰. Ndërkohë për të shtypur rezistencën e atyre që nuk donin t’i çojnë kalamajtë në shkolla shqipe do të aplikoheshin dënimet e praktikuara për arsimin e detyrueshëm⁶¹.

Gjithashtu, problem ishte arsimimi në gjuhën greke i atyre familjeve minoritare, të cilat ishin larguar nga zona e minoritetit. Kjo veçanërisht në kushtet kur neni 28 i Statutit të RPSH sanksiononte se shkolla ishte nën kontrollin e shtetit dhe se “nuk mund të hapen shkolla private veçse me ligj”⁶². Duke qenë se shteti nuk mund të merrte përsipër arsimimin e këtyre minoritarëve të larguar nga zona e minoritetit, ata shkolloheshin si shqiptarët dhe në kontakt të vazhdueshëm me mjedisin shqiptar kishte raste kur e humbnin ndërgjegjen greke dhe integroheshin plotësisht me jetën shqiptare. Ky proces është i natyrshëm dhe ndodh rëndom në të gjitha shtetet, qoftë dhe demokratike. Nuk mendoj se kishte ndonjë presion politik shtetëror për t’u humbur këtyre minoritarëve identitetin e tyre.

Një vështirësi që ndeshej gjatë vitit 1944-1948 për shkollimin e minoritetit grek në gjuhën e tyre ishte mungesa e mësuesve, qoftë në numër, qoftë në shkallën e kualifikimit të tyre. Nga statistikat zyrtare kuptojmë se ndërsa ishte rritur numri i shkollave në krahasim me vitet 1936-1937, ishte ulur numri i mësuesve nga 126 në 101. Çfarë kishte ndodhur? Siç është përmendur, në periudhën midis dy luftërave përgatitja e mësuesve për shkollat e minoritetit ishte bërë në shkollën Seminar-Normal i Vellas në Janinë, hapur në vitin 1911, si dhe në Liceun e Voshtinës. Pas luftës një pjesë e këtyre mësuesve, të cilët kishin marrë

⁵⁹ *Po aty.*

⁶⁰ *Po aty.*

⁶¹ Sipas Ligjit të detyrimit arsimor të vitit 1946, prindërit të cilët nuk respektonin arsimin e detyrueshëm dënoheshin t’i paguanin shtetit një gjobë prej 400 lekë deri në privim lirie. Për më tepër shiko: E. Kambo, *Arsimi në Shqipëri ...*, f. 55.

⁶² Asambleja Kushtetuese, *Statuti i RPSH ...*, f. 12.

pjesë në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare si rasti i Lefter Talos, kishin rënë dëshmorë, ndërsa pjesa tjetër ishin inkuadruar me punë në ushtri dhe në pozicione administrative. Pjesa tjetër e mësuesve, të cilët nuk kishin mbështetur Lëvizjen, ashtu si në gjithë Shqipërinë, u larguan gradualisht nga arsimi si të papërshtatshëm për edukimin e brezit të ri. Qeveria komuniste mendonte se “një bazë për reaksionin dhe agjentët e reaksionit në minoritet janë mësuesit. Zbulimet e kohëve të fundit e kanë vërtetuar këtë më mirë, për këtë u vendos të pushohen mësuesit minoritarë që nuk janë lidhur me ne, për më tepër punojnë për reaksionin”⁶³. Në vijim të kësaj politike, KANÇI në prill 1945, nxori një urdhër për të ndaluar studentët e shkollave të mesme të shkojnë për studime në liceun e Voshtinës “deri sa gjendja politike në Greqi të jetë e turbullt si deri sot”⁶⁴. Ky vendim jo vetëm krijonte probleme për arsimimin e lartë të minoritetit grek, por krijonte mungesa në vazhdimësi për mësues të kualifikuar.

Për ta mbushur këtë boshllëk që ishte krijuar në lidhje me arsimtarët për minoritetin grek qeveria shqiptare mori disa masa. Në Plenumin e 9 marsit 1946 të komitetit qarkor të PKSh për qarkun e Gjirokastrës, në lidhje me plotësimin e kuadrit arsimor u vendos së pari që elementët e pushuar si reaksionarë “të zëvendësohen me elementë të rinj, qoftë me tre, katër, pesë klasë shkollë të mesme, por që janë lidhur me ne”⁶⁵. Gjithashtu u vendos “të çelet një kurs për të nxjerrë mësues të rinj nga elementa që janë më të lidhur me ne”⁶⁶. Në zbatim të këtyre vendimeve, prej 25 korrikut 1946 deri më 25 tetor 1946 u hap një kurs 3/mujor me 42 kursantë për përgatitjen e arsimtarëve të rinj për minoritetin grek⁶⁷. Programi i kursit kishte si lëndë kryesore: gjuhën greke, pedagogji, psikologji, didaktikë. Me këtë kontingjent arsimtarësh u hapën shkolla në të gjitha fshatrat e minoritetit. Një kurs i ngjashëm 45 ditor u zhvillua dhe

⁶³ *AQSH*, Fondi 14/AP, viti 1946, dos. 6, fl. 45, Konkluzion i Plenumit të komitetit qarkor të PKSH të qarkut të Gjirokastrës, 9 mars 1946.

⁶⁴ *Po aty*, Fondi 489, viti 1945, dos. 138, fl. 1, Letër e Kryesisë së KANÇI për Këshillin Nacionalçlirimtar të Gjirokastrës, nr. 012, 23 prill 1945.

⁶⁵ *Po aty*, F. 14/AP, viti 1946, dos. 6, fl. 45, Konkluzione të Plenumit të komitetit qarkor të PKSH të qarkut të Gjirokastrës, 9 mars 1946.

⁶⁶ *Po aty*.

⁶⁷ *Po aty*, Fondi 14/AP, viti 1946, dos. 10, fl. 7, Raport i Komitetit Ekzekutiv të Prefekturës së Gjirokastrës për vitin 1946.

në verën e vitit 1947. Ndryshe nga ai i vitit 1946, në të morën pjesë arsimtarë me gjimnaz të mbaruar.

Një hap i rëndësishëm në përgatitjen e arsimtarëve për shkollat e minoritetit ishte hapja në vitin 1945 e liceut të gjuhës greke në Gjirokastrë. Iniciatorë për hapjen e tij u bë një grup intelektualësh minoritarë, të cilët në korrik 1945, ia shprehën këtë dëshirë Ministrit të Drejtësisë, Manol Konomit, gjatë vizitës së tij në zonën e minoritetit⁶⁸. Në tetor 1945, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Nacionalçlirimtar të Gjirokastrës i paraqiti kërkesën Ministrisë së Arsimit, e cila me një urdhër lejoi hapjen e një liceu grek në Gjirokastrë. Pas një konkursi për pranimet e nxënësve në këtë shkollë, më 10 dhjetor 1945, filluan mësimet. Mësuesit e parë të gjimnazit në gjuhën greke për minoritetin ishin dhe dy komunistë grekë të EAM-it Jorgos Nikolis dhe Themistoklis Milis, si dhe minoritari Jorgos Memos nga Dhivri i Delvinës. Hapja e një gjimnazi në gjuhën greke kishte një rëndësi të veçantë për ruajtjen e identitetit gjuhësor të minoritarëve grekë. Ajo do të siguronte shkollimin në nivel të lartë për të rinjtë e minoritetit grek, si dhe mësues të kualifikuar për shkollat e minoritetit. Sasia e shkollave të hapura në zonën e minoritetit grek flet për kujdesin e shtetit shqiptar për arsimimin popullsisë minoritare.

Tipar i ruajtjes së identitetit gjuhësor të minoritetit është programi mësimor për këto shkolla. Gjatë viteve 1944-1948, raporti në mësimin e gjuhës greke dhe asaj shqiptare ishte më se i përshtatshëm për mbrojtjen e gjuhës amtare të minoritetit grek. Deri në vitin 1951, nxënësit e minoritetit grek i mësonin në gjuhën greke të gjitha lëndët nga klasa I-VII, ndërsa gjuhën shqipe fillonin ta mësonin në klasat V-VII si gjuhë të huaj, pra me disa orë në javë. Këtë raport mes mësimin të greqishtes dhe shqipes në shkollat e minoritetit na e vërtetojnë dhe misionet civile dhe ushtarake perëndimore në Shqipëri. Kështu, në raportin e kolonel Palmerit për Forin Office në korrik 1945 thuhet se, në zonat me popullsi dërrmuese greke “janë hapur shkolla fillore, të cilat 80% të kohës e kanë në gjuhën greke, dhe 20% të kohës në gjuhën shqipe”⁶⁹. Një raport i tillë siguron aftësi mjaft të mira të nxënësve grekë në gjuhën amtare, por

⁶⁸ “Arsimi në minoritet” në: *Bashkimi*, 27 shtator 1945.

⁶⁹ *AMPJ*, viti 1945, dos. 11, fl. 136, Çështja e minoritetit grek në këndvështrimin e misioneve perëndimore që gjendeshin në Shqipëri gjatë vitit 1945-1946.

krijon vështirësi në mësimin e gjuhës së shtetit ku jetojnë, pra pengon integrimin e tyre.

Tipar tjetër përcaktues në ruajtjen e gjuhës amë të një minoriteti, por dhe të identitetit kombëtar të tij në përgjithësi, është dhe përmbajtja e teksteve shkollore. Gjatë viteve 1944-1946, për shkollat e minoritetit, u përdorën programet dhe tekstet shkollore që ishin botuar gjatë periudhës midis dy luftërave⁷⁰. Të paktën këtë të dhënë na e jep Shefi i UNRRA-s Floud gjatë vizitës së tij në Shqipërinë e Jugut kur thotë: “shikova librat e parë shkollorë që përdorëshin dhe pashë se ishin të gjithë libra shkollorë grekë të botuar në kohën e Zogut”⁷¹. Duke qenë se pjesa më e madhe e tyre ishin hartuar dhe shtypur në Greqi, nuk ka dyshim se ato i shërbenin shumë mirë mbrojtjes së identitetit kombëtar grek të këtij minoriteti.

Pas Reformës Arsimore të vitit 1946, u shtrua nevoja për të prodhuar tekste të reja për shkollën e minoritetit grek, ashtu si dhe për shkollat shqiptare. Në bazë të Reformës Arsimore në shkollë u shtuan lëndë të reja “absolutisht të domosdoshme” për regjimin si Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Kushtetuta etj⁷²: Kjo paraqiste vështirësi të shumta, pasi nuk kishte mjetet e domosdoshme për të shtypur tekste të reja për shkollën greke. Krahas specialistëve për hartimin e tyre kishte dhe mungesa teknike si: mungesë shkronjash, letre etj. Marrëdhëniet e acaruar shqiptaro-greke, si dhe drejtimi i ndryshëm politik dhe ideologjik e bënë të pamundur të kërkohej ndihma e shtetit grek për të shtypur librat në shtypshkronjat greke. Në një relacion të veçantë të Komitetit qarkor të Gjirokastrës për Seksionin e Agjit-Propit në KQ të PKSH theksohej rëndësia dhe nevoja e shkronjave për shtypjen, sidomos të librave. “Pritnim për të filluar shtypjen e disa teksteve shkollore të klasit të I dhe të II të fillores, - thuhet në relacion, - por akoma nuk po na vijjnë dhe në qoftë se do të vonohet dërgimi nuk do të shtypen për këtë vit”. Në fakt, sipas relacionit të Sekretarit të KQ të PKSH, kishin arritur të botoheshin në shtypshkronjën e gazetës Laiko Vima, në Gjirokastër, tekstet e shkollave të minoritetit si: Abetarja dhe

⁷⁰ Deri në miratimin e Ligjit për Reformën Arsimore të vitit 1946, të gjitha shkollat në Shqipëri përdornin tekstet dhe programet që kishin qenë në qarkullim në periudhën midis dy luftërave dhe gjatë LIIB. Për më tepër shih: E. Kambo, *Arsimi në Shqipëri ...*, f. 176.

⁷¹ AMPJ, viti 1945, dos. 11, fl. 146.

⁷² E. Kambo, *Arsimi në Shqipëri ...*, f. 177-178.

Këndimi për klasat e I, II, III, IV⁷³. Me vështirësi të madhe u shtyp në redaksinë e gazetës Laiko Vima një antologji për liceun grek të Gjirokastrës me titull “Për ty Liri” (Ja sena Elefteria). Tekstet dhe programet për shkollat e minoritetit grek kishin ngarkesat politike, nga të cilat vuanin të gjitha tekstet dhe programet shkollore në Shqipëri. Kështu, kishin filluar të përfshiheshin në tekstet shkollore tema për edukimin komunist të nxënësve. Por në tekstet shkollore të kësaj periudhe, madje dhe ato në qarkullim gjatë viteve ’50, minoritarëve u mundësohej gjithashtu edhe krijimi i një ndërgjegjeje kombëtare greke⁷⁴. Me anë të teksteve të minoritetit grek mësohej në mënyrë të kënaqshme gjuha greke, gjithashtu në to u bëhej jehonë përpjekjeve të përbashkëta të minoritetit grek dhe të komunistëve shqiptarë për krijimin e Demokracisë Popullore në Shqipëri. Për më tepër ato mbanin në konsideratë marrëdhëniet e minoritetit grek me të gjithë botën greke⁷⁵.

Arsimimi i minoritetit maqedonas në gjuhën amtare. Shteti shqiptar garantonte për minoritetin maqedonas, ashtu si dhe për minoritetin grek, të drejtën e tij për t’u shkolluar në gjuhën amtare. Nëse do të përpiqemi të krahasojmë gjendjen e arsimit të minoritetit maqedonas me atë grek, mund të vërejmë se vështirësitë në shkollimin e minoritetit maqedonas nuk ishin të pakta. Arsimimit të minoritetit maqedonas nuk i ishte kushtuar ndonjë vëmendje e veçantë në periudhën midis dy luftërave, e për rrjedhojë kishte më shumë mungesa në godina, në mësues dhe në tekste shkollore, sesa në zonën ku jetonte minoriteti grek. Por, ndryshe nga minoriteti grek, ai maqedonas lejohej të kishte si mbështetës shtetin amë, i cili kishte të njëjtën ideologji me shtetin shqiptar dhe arriti të zgjidhë shumë nga mungesat në shkollimin e fëmijëve maqedonas, duke u siguruar atyre ruajtjen e identitetit të tyre gjuhësor.

Hapja e shkollave në zonën ku jetonte minoriteti maqedonas në Shqipëri filloi në vitin 1944. Për vitin shkollor 1944-1945 nuk ka statistika mbi sasinë e shkollave që funksiononin në minoritetin maqedonas, si dhe për numrin e mësuesve dhe të nxënësve. Në

⁷³ AQSH, Fondi 14/AP OU, viti 1949, dos. 86, fl. 24-25/, Relacion i Sekretariatit të KQ i PPSH mbi botimet e minoritetit.

⁷⁴ Evangelos Kofos, “The Greek minority school textbooks during the Enver Hoxha period”, në *Balkan Studies*, 1993, Vol. 34, No. 1, f. 86.

⁷⁵ Po aty.

përgjithësi statistikat për këtë minoritet nuk janë të plota. Në vitin shkollor 1945 -1946 dhe 1946-1947, me urdhër të Ministrisë së Arsimit, u çelën dhe funksionuan 8 shkolla në gjuhën maqedonase, 6 në Prefekturën në Qendër, pra në zonën e Prespës dhe 2 në atë të Bilishtit, në fshatrat Cerje dhe Vërnik⁷⁶. Gjatë vitit shkollor 1947-1948, sipas njoftimeve të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit të Korçës ishin hapur nga një shkollë në fshatrat Bezmisht, Goricë, Pustec, Shulin, Zaroshkë. Nuk ishte hapur shkolla në fshatin Gollomboç për shkak të mungesës së mësuesit⁷⁷. Shkolla më e madhe në minoritetin maqedonas ishte ajo e Pustecit, e cila në vitin 1947 kishte 80 nxënës⁷⁸. Vazhdonin të funksiononin gjithashtu dhe dy shkolla në gjuhën maqedonase në fshatrat Cerje dhe Vërnik të Prefekturës së Bilishtit⁷⁹. Me urdhër të ministrit të arsimit, Kristaq Cipo, nga janari 1946, është lejuar hapja e një shkolle në gjuhën maqedonase në katundin Kërçisht i Epërm, e cila “do të veprojë sipas programës dhe rregulloreve e ligjeve të shtetit shqiptar”⁸⁰.

Në lidhje me raportin gjuhë shqipe - gjuhë amtare, raporti ishte tërësisht në favor të gjuhës amtare, pasi në bazë të politikës së shtetit shqiptar, në ciklin fillor mësimet në shkollat e minoritetit bëheshin tërësisht në gjuhën amtare. Duke qenë se gjer në vitin 1947 në zonën ku jetonte minoriteti maqedonas kishte vetëm shkollë fillore, kuptohet që mësimet zhvilloheshin tërësisht në gjuhën maqedonase. Përfundim bënte shkolla në gjuhën maqedonase në katundin Kërçisht i Epërm, në të cilën mësimet zhvillohen në maqedonisht, por “prej klasës së III do të bahen edhe nga tre orë gjuhë shqip në javë”⁸¹. Arsimi 7-vjeçar në këtë zonë filloi vetëm në vitin shkollor 1948-1949. Në bazë të urdhrit të Ministrisë së Arsimit gjatë vitit shkollor 1946-1947 ishte programuar për të filluar dhe mësimi i gjuhës shqipe, por kjo nuk u arrit për shkak të mungesës së

⁷⁶ *AQSh*, Fondi 511, viti 1947, dos. 21, fl. 1, Shkresë e Ministrisë së Arsimit për Komitetin Ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit të Korçës, 5 nëntor 1947.

⁷⁷ *Po aty*, fl. 7, Shkresë e Ministrisë së Arsimit për Seksionin e Arsimit të prefekturës Korçë.

⁷⁸ *Po aty*, fl. 1, Shkresë e Ministrisë së Arsimit për Komitetin Ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit të Korçës, 5 nëntor 1947.

⁷⁹ *Po aty*, fl. 3, Shkresë e Ministrisë së Arsimit për prefekturën e Bilishtit, 9 dhjetor 1947.

⁸⁰ *Po aty*, Fondi 490, viti 1946, dos. 157, fl. 1, Letër e Ministrisë së Arsimit për Komitetin Ekzekutiv të këshillit popullor të qarkut të Peshkopisë, 28 janar 1946.

⁸¹ *Po aty*.

personelit mësimor dhe për shkak të largësisë që kishin këto zona, vështirësisë së rrugëve dhe mjeteve të transportit⁸².

Ashtu si për shkollat e minoritetit grek edhe në shkollat e minoritetit maqedonas kishte mungesë të theksuar të mësuesve të kualifikuar. Në vitin 1945 në këto shkolla jepnin mësim 8 mësues, shtatë prej tyre kishin kryer vetëm 5-7 vjet shkollim, ndërsa vetëm njëri prej tyre kishte mbaruar Akademinë Tregtare. Çështja e sigurimit të personelit të mësuesve për shkollat e minoritetit maqedonas u zgjidh gjatë viteve në vazhdim. Në nëntor të vitit 1945, u nënshkrua një marrëveshje shqiptaro-jugosllave, sipas së cilës qeveria shqiptare do të lejonte dërgimin e disa mësuesve nga Republika e Maqedonisë, për të lehtësuar funksionimin e këtyre shkollave⁸³. Në vitin 1947, Ministria e Arsimit e RPSH i kishte dërguar Legatës Jugosllave në Tiranë një kërkesë për qeverinë jugosllave, me anë të së cilës i kërkonte kësaj të fundit të dërgonte dy mësues për shkollat e minoritetit maqedonas “një për Gollomboçin dhe tjetri për fuqizimin e shkollës së katundit Pustec, e cila këtë vit ka 4 klasë me më tepër se 80 nxënës”⁸⁴. Mësuesit nga Republika e Maqedonisë, sipas një marrëveshje të arritur më parë mes qeverisë shqiptare dhe asaj jugosllave, përfitonin një pagë të leverdishme. Në lidhje me këtë Ministria e Arsimit njofton Prefekturën e Korçës si më poshtë: “për sa i përket rrogave të personelit mësimor të këtyre shkollave çështja të zgjidhet në këtë mënyrë: në qoftë se mësuesit e këtyre shkollave do të kenë shtetësi jugosllave do të përfitojnë shtesën prej 50% mbi rrogën, ashtu sikurse mësuesit shqiptarë që mësojnë në viset jugosllave”⁸⁵.

Një problem shqetësues ishte sigurimi i teksteve për shkollat e minoritetit maqedonas. Gjatë vitit shkollor 1945-1946, sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit kishte mungesa të theksuara në të gjitha tekstet shkollore për shkollat e minoritetit maqedonas. Në bazë të një marrëveshjeje të përfunduar më parë mes Ministrive të Arsimit të RPSH dhe RFJ, parashikohej që shkëmbimi i teksteve shkollore për minoritetin maqedonas në Shqipëri dhe atë shqiptar në Jugosllavi të bëhej nga

⁸² *Po aty*, Fondi 511, viti 1947, dos. 21, fl. 7, Shkresë e Ministrisë së Arsimit për Seksionin e Arsimit të prefekturës Korçë

⁸³ Hugh Poulton, *The Balkans, minorities and the status in conflict*, 2nd edition, London: Minority Rights Publication, 1994, f. 202.

⁸⁴ *AQSh*, Fondi 511, viti 1947, dos. 21, fl. 7, Shkresë e Ministrisë së Arsimit për Seksionin e Arsimit të prefekturës Korçë.

⁸⁵ *Po aty*.

qeveritë përkatëse⁸⁶. Në muajin maj 1946, sipas të dhënave të Ministrisë së Jashtme jugosllave, “Komitetet Popullore të krahinave të Manastirit dhe të Dibrës në Republikën Popullore të Maqedonisë, kanë dërguar tashmë abetare për shkollat e minoritetit maqedonas”⁸⁷. Gjithashtu, qeveria jugosllave kishte premtuar se “do t’ju dërgohen shkollave të naltpërmendura edhe botime të tjera si: gramatika, libra leximi për klasat e mesme, instruksione mbi abetaret dhe përmbledhje të ndryshme novelash dhe poezirash”⁸⁸.

Në korrik 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit të Korçës, njoftonte Ministrinë e Arsimit se gjatë vitit shkollor 1945-1946 kishte pasur mungesa të ndjeshme në tekstet shkollore për minoritetin maqedonas. Duke qenë se mungesat e shumta në tekstet shkollore rrezikonin fillimin e vitit të ardhshëm shkollor për minoritetin maqedonas, Ministria e Jashtme shqiptare i kërkoi në mënyrë të përsëritur qeverisë jugosllave gjatë muajit gusht dhe shtator 1946, të dërgonte për klasat e këtyre shkollave libra leximi e libra të tjera, për vitin e ardhshëm shkollor 1946-1947⁸⁹. Por mesa duket dhe viti shkollor 1946-1947 filloi me të njëjtat mungesa në tekstet shkollore të minoritetit maqedonas. Legata shqiptare në Beograd ia ripërsëriti qeverisë jugosllave kërkesën për t’i dërguar tekstet e kërkuara edhe në nëntor të vitit 1946. Gjatë vitit 1947 dhe 1948 nuk është përsëritur kërkesa për dërgimin e teksteve, gjë që na bën të mendojmë se kjo çështje është zgjidhur.

Gjatë viteve 1945-1948, shteti shqiptar kishte garantuar arsimimin e minoritetit maqedonas në shkallën më të mirë të mundshme për kushtet e Shqipërisë. Por ky “zell” nuk mund të themi se vazhdoi edhe në vitet që

⁸⁶ Në vjeshtën e vitit 1947 Ministria e Arsimit e Shqipërisë i njofton Ministrinë së Jashtme jugosllave se kishte gati të gjitha tekstet shkollore për shkollën fillore si dhe tekstin e historisë dhe antologjisë shqipe për shkollat e mesme të RPSH. Nëse qeveria jugosllave kishte nevojë për këto tekste për shkollat e Kosmetit dhe Maqedonisë duhet të dërgonte sa më parë sasinë e librave të çdo lloji (që nevojitej - S.B.) dhe letrën që do të nevojitej për to. Në përgjigje të kësaj letrë, Ministria e Arsimit të Jugosllavisë përgjigje se autoritetet kompetente në Jugosllavi e kishin gati sasinë e letrës për tekstet e përmendura, por më përpara kërkonin që të dërgohej nga Ministria e Arsimit një ekzemplar për çdo libër për të pasur më parë pëlqimin e ministrisë së Arsimit të Serbisë. Për më tepër shiko: *AMPJ*, viti 1946, dos. 110, fl. 40, 46.

⁸⁷ *AMPJ*, viti 1945, dos. 110, fl. 33, Legata shqiptare në Beograd për Ministrinë e Jashtme, 3 maj 1946.

⁸⁸ *Po aty*.

⁸⁹ *Po aty*, viti 1946, dos. 110, fl. 30, Ministria e Jashtme për Legatën shqiptare në Beograd, 21 gusht 1946.

pasuan. Pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, shkollimi i minoritetit maqedonas hasi në vështirësi më të mëdha. Pas vitit 1948 nuk dokumentohet asnjë shkollë maqedonase në zonën e Gollobordës, gjithashtu u mbyllën dhe shkollat maqedonase të hapura në fshatrat Cerje dhe Vërnik, si shkolla në të cilat zhvillohej fryma trockiste. Gjithashtu, u larguan dhe mësuesit jugosllavë dhe u zëvendësuan me vendas, por pa arsimin përkatës. Gradualisht u hoqën nga qarkullimi dhe tekstet e ardhura nga Jugosllavia, gjë që i detyroi fëmijët maqedonas të mësonin me tekste në formë dispense.

Në përfundim, mund themi se pavarësisht të metave, vështirësive objektive dhe subjektive që përballej shteti komunist shqiptar në raport me identitetin kombëtar të minoriteteve, ai gjatë viteve 1944-1948 arriti të siguronte kushte të mjaftueshme për mbrojtjen e tij. Madje dhe në vazhdim, politika që ndoqi shteti shqiptar krijoi më pak probleme me minoritetet se çdo shtet tjetër i qeverisur nga komunistët në Gadishullin e Ballkanit⁹⁰.

S u m m a r y

THE POLITICS OF THE ALBANIAN COMMUNIST GOVERNMENT ON MINORITIES IN ALBANIA (1944 – 1948)

This article aims to analyze the main directions of the politics led the Albanian government, on minorities that live in Albania. It emphasizes the fact that, due to the small specific spread of these minorities in the Albanian society, they did not constitute a disturbing subject for the Albanian government. In consequence, the Albanian communist government did not compile any specific political platform concerning the minorities. The politics of the Albanian government on minorities were based on the principles of the proletarian internationalism and were drawn depending on the specific situations that would appear. During the years 1944 – 1948, just as during the period between the two World Wars, the concerns and politics of the Albanian government were concentrated on the Greek minority, not only due to its being the largest minority in the country, but also due to the specificities that it presented.

The principal directions of the politics of the Albanian government on minorities are analyzed in the article categorized in three groups:

⁹⁰ Evangelos Kofos, “Balkan minorities under communist regimes”, në *Balkan Studies*, vol. 2, nr. 1-2, Thesaloniki 1961, f. 42.

The State of Albania aimed to create the necessary conditions for the integration of the minorities in the political, economic and cultural life of the country, by accepting them as citizens with equal rights.

The State of Albania was bind to create the elements, which would guarantee the preservation of the national identity of the minorities. Despite all the incompleteness and the lacks that can be observed during this process, the Albanian government created the possibilities for an education in the native languages and the preservation of the traditional culture belonging to each minority.

A particular importance was given to the establishment of politics able to eliminate the ethnic differentiation inside the country. That was a precondition for the political and social cohesion inside the communist Albania, as well.